



Saturni tanimë ka edhe një unazë të re, kurse Sistemi ynë Diellor ndër më të madhen. Unaza shumë e madhe e përbër nga pluhuri u zbulua nga një grup shkenctarësh hulumtues amerikan nga Universiteti i Virxhinias me ndihmen e teleskopt hapësinor „Spitzer“.

Kjo unazë ka një diametër prej 26 milionë kilometrash dhe është aq i madh, saqë Toka një miliardë herë do të hynte në të. Po të mund të shikohej kjo unazë nga Taka, kështu njëtojn shkencëtarët, atëherë kjo do të na duket neve dy herë më i madh sesa Hëna e plotë.

Grimcat e pluhurit të unazës mendohet se krijohen nga hëna e Saturnit të quajtur "Phoebe". Kjo unazë do të mund ta zghidh enigmën me të cilën që shumë kohë merren astronomët. Fjala është për pyetjen, pse faqja e përparme e hënës së saturnit "Iapetus" ("Giapetos") në drejtim të fluturimit është parimisht më e errët sesa ajo e mbrapme.

Shkencëtarët hulumtues llogarisin në atë se unaza e re e zbuluar ka dërguar në të kaluaren mjaftë material në sistemin Diellor, ashtu që pjesa e përparme e "Iapetus-it" të mbulohet me një shtesë të lartë pluhuri prej një metri.

FOTO: Unaza e re e planetit Saturn dhe Hënat e tij Phoebe dhe Iapetus.

Nga gjermanishtja: Autori i webfaqes

[www.astroalba.de](http://www.astroalba.de)

Burimi: dpa, AFP dhe NASA.